

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi, TM1 2025


30.04.2025

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Indeksin e Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi për tremujorin e parë (TM1) 2025.

Rritet indeksi i përgjithshëm i çmimeve të prodhimeve bujqësore në TM1 2025, krahasuar me TM1 2024

Ky publikim është i bazuar në grumbullimin e çmimeve të prodhimeve bujqësore vendore në Kosovë. Grumbullimi i të dhënave është bërë në treg, ferma dhe vendet të tjera, ku çmimet e prodhimeve bujqësore mund të grumbullohen.

Indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore, blegtorale dhe totali i prodhimeve bujqësore TM1 2020-2025, (2020=100)



Në TM1 2025, indeksi i çmimeve të prodhimeve bimore ka rritje për (0.6%), krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024. Indeksi i çmimeve të prodhimeve blegtorale ka rritje për (4.7%), krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024.

Indeksi i përgjithshëm i prodhimeve bujqësore ka rritje për (2.9%), krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024.

Ndryshimi në %, TM1 2025 me TM1 2024

Përshkrimi	TM1 2024	TM1 2025	Ndryshimi në %
Prodhimet bimore	146.7	147.6	0.6
Prodhimet blegtorale	142.7	149.4	4.7
Totali prodhimeve bujqësore	144.4	148.6	2.9

Prodhimet që krijojnë bazë për indeksin e çmimeve të prodhimeve bujqësore janë ndarë në dy grupe kryesore: Prodhimet bimore dhe ato blegtorale. Në kuadër të prodhimeve bimore, çmimet janë grumbulluar për këto grupe: drithëra, bimë foragjere, perime, patate dhe pemë. Në prodhimet blegtorale çmimet janë grumbulluar për blegtorinë dhe prodhimet blegtorale. Në kuadër të blegtorisë, çmimet grumbullohen për katër kategori të kafshëve: gjedhe, dele, derra dhe pula. Këto çmime janë bazuar në peshën e gjallë të kafshëve. Në kuadër të prodhimeve blegtorale çmimet janë grumbulluar për: qumësht, vezë dhe mjaltë. Të gjitha çmimet janë llogaritur në Euro dhe njësitë matëse janë në: kg, litër dhe copë.

Për më shumë informata lidhur me Indeksi i Çmimeve të Prodhimeve dhe Çmimet në Bujqësi, për TM1 2025 (2020=100), vizitoni: <https://ask.rks-gov.net/Themes/Agriculture>